



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:139196
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728804

C.nr.2177/2023

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – **Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, me gjyqtar Agron Karatash dhe me zyrtaren ligjore I.R. në çështjen juridiko-kontestimore të paditëses S.E. nga Prizreni, të cilën e përfaqëson, av.Xh.E. nga Prizreni kundër të paditurës, KS EUROSIG me seli në prishtinë, për kompensimin e dëmit, me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet se padia e paditëses S.E. nga Prizreni, në këtë çështje juridiko-kontestimore, **është e TËRHEQUR.**

A r s y e t i m

Paditësja S.E. të cilën e përfaqëson av.Xh.E. nga Prizreni pranë kësaj gjykate me datë 21.06.2023 ka parashtruar padi kundër të paditurës KS EUROSIG me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit.

Me datë 21.05.2024, i autorizuari i paditëses pranë kësaj gjykate ka dorëzuar një parashtrësë me anë të cilit ka theksuar se të njëjtit për shkak se kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore e bëjnë tërheqjen e padisë.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 261.1, në lidhje me nenin 261.3 dhe 142.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore -LPK.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:139196, 23.05.2024**

Gjyqtari,

Numri i lëndës: 2023:139196
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728804

Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Bazuar në nenin 261.4 të LPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa